



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:224201

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05487548

P.nr.333/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në lëndën penale kundër të pandehurit V...P..., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 2 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: KPRK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.I.nr.404/2022, të datës 21.06.2023, duke vendosur lidhur kërkesën për hedhjen e aktakuzës të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit V...P..., avokat Dejan Vasiq, në mbështetje të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje si: KPP), me datën 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET Kërkesa për hedhjen e aktakuzës e datës 07.08.2023, e paraqitur nga mbrojtësi i të akuzuarit V...P..., avokat Dejan Vasiq paraqitur ndaj aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr.404/2022 të datë 21.06.2023.
- II. HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr.404/2022, e datës 21.06.2023 kundër të pandehurit V.... P..., nga i ati R..., e ëma S..., e vajzërisë N..., i lindur më 04.11.1989, në Vranje, me vendbanim në rrugën V.... S... .., me numër personal, serb, shtetas i Serbisë.
- III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit V...P... për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 2 të KPRK, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme të cilat e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.
- IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.I.nr.404/2022, të datës 21.06.2023, kundër të pandehurit V...P... për shkak të veprave penale: I. Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar dhe shitja e narkotikëve dhe substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK-së dhe II. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.2 të KPRK-së.

Gjykata (Departamenti i Krimeve të Rënda i kësaj Gjykate), e ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri ka deklaruar se pranon fajësinë për veprën penale nga pika I dhe gjykata e ka miratuar pranimin e fajësisë. Duke qenë se i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për pikën II, atëherë gjykata në kuptim të nenit 242 par.8.2 të KPP-së, e ka veçuar procedurën për pikën II, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.2 të KPRK-së.

Bazuar në nenin 22 të Kodit të Procedurës Penale Nr.08/L-032, që ka hyrë në fuqi më 18 Shkurt 2023, vepra penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.2 të KPRK-së, bie në kompetencë të Departamentit të Përgjithshëm.

Gjykata në përputhje me dispozitat e KPP-ës, i'a ka dhënë mundësinë të akuzuarit që të paraqesë kundërshtimet e tij në afatin e paraparë ligjorë, e që mbrojtësi i të akuzuarit V...P... avokat Dejan Vasiq, brenda afatit të paraparë ligjorë ka paraqitur kundërshtimin me kërkesë për hudhje të aktakuzës.

Kundërshtimet e palëve:

Mbrojtësi i të pandehurit V...P..., avokat Dejan Vasiq, në kundërshtimin e datës 07.08.2022, i ka propozuar gjykatës që të hedhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për faktin se prova lidhur me fotografitë e armëve të cilat janë marrur nga telefoni për të cilën akuzohet i pandehuri nuk është vepër penale.

Përgjigja e prokurorisë në kundërshtim:

Gjykata i'a ka dërguar Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, një kopje të kundërshtimit të paraqitura nga mbrojtësi i të pandehurit V...P..., avokat Dejan Vasiq, për përgjigje në kundërshtim, kjo Prokurori me datë 29.08.2023 ka paraqitur përgjigje në kundërshtim, duke i propozuar Gjykatës që të vazhdojë me shqyrtimin gjyqësor sepse prokuroria vlerëson se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri V...P... ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, gjithashtu vërtetohet me provat të cilat i ka siguruar prokuroria gjatë hetimeve dhe atë: memorandum zyrtar i datës 28.10.2022, vërtetimi për marrjen e sendeve, procesverbali mbi bastisjen e personit, ekspertiza e datës 13.06.2023, fotodokumentacioni si dhe shkresat tjera të cilat gjenden në lëndë, andaj në të gjitha këto ka kërkuar nga gjykata që ta refuzoj kundërshtimin e mbrojtësi të të pandehurit, si të papabazuar.

Gjykata, duke vlerësuar pretendimet në kundërshtimin e mbrojtësit të të pandehurit, përgjigjen e Prokurorisë lidhur me kundërshtimin si dhe pasi që ka shqyrtuar në tërësi provat dhe shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjetjet e Gjykatës:

Gjykata, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, e duke u bazuar edhe në aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.I.nr.404/2022, e datës 21.06.2022, kundër të pandehurit V...P..., sa i përket veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 2 të KPRK-së, e ka aprovuar kundërshtimin e mbrojtësit të të pandehurit, avokat Dejan Vasiq.

Gjykata vlerëson se prokuroria nuk ka paraqitur asnjë provë se i pandehuri ka mbajtur, kontrolluar ose poseduar armë gjatë kohës se kryerjes se veprës penale dhe në bazë të të cilave do të vërtetohet dyshimin e bazuar mirë se i njëjti e ka kryer këtë vepër penale.

Neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së, ka përcaktuar se: *“1. Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet. “.* Kjo dispozitë ka përcaktuar në mënyrë alternative inkriminimin në këtë vepër penale dhe atë, personi që e mban armën në pronësi; personi që është në kontroll të armës dhe rasti i tretë që duhet të shprehet në mënyrë kumulative me ndonjërin nga rastet paraprake është që personi është në posedim të paautorizuar. Në rastin e parë, mbajtja në pronësi, ka kuptimin kur i pandehuri është pronar i armës të cilën edhe e mban në posedim faktik, i dyti ka kuptimin kur i pandehuri ka kontroll mbi armën edhe për kundër që mbi të njëjtën nuk e ka pronësinë, kjo mund të shprehet në disa forma dhe atë njëra ndër format është, kur i pandehuri e mban armën e cila është e personit tjetër me qëllim të ruajtjes së saj, dhe forma e tretë është që arma të jetë në posedim të paautorizuar, pra, që personi që e ka në posedim apo kontroll armën për të njëjtën nuk duhet të ketë autorizim, vetëm në këto raste do të mund të vije në shprehje vepra penale nga neni 366 i KPRK-së.

Ndërsa në paragrafin 2 të nenit 366 të KPRK-së, është përcaktuar se: *“2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.”*, pra kjo dispozitë ka paraparë formën e cilësuar të veprës penale nga paragrafi 1, për rastet kur sasia e gjetur e armëve apo municionit tek i pandehuri, është më e madhe.

Prokuroria nuk ka paraqitur asnjë dëshmi të vetme që do të vërtetonte se i pandehuri ka qenë në pronësi të armës, në posedim apo kontroll të saj. Për më tepër, armët nuk janë gjetur në shtëpinë e të pandehurit, nuk ka asnjë dëshmi se ai e ka blerë armë. Nuk mund të dëshmohet se i pandehuri i ka poseduar armët siç nuk mund të vërtetohet as fakti i kontrollit mbi armët, përderisa në shtëpinë e tij nuk janë gjetur armë gjatë bastisjes por vetëm nga ekzaminimi i telefonit të tij të cilat kanë qenë vetëm foto të armëve.

Gjykata vëren faktin se prokuroria është bazuar vetëm në ekspertizën në të cilën shihen fotografitë të cilat janë gjendur në telefonin e tij me rastin e kontrollit të banesës së të pandehurit, të cilat janë fotografi të armëve, mirëpo përderisa nuk ka asnjë dëshmi se i

pandehuri, siç u theksua më lartë, ka pasur në pronësi, kontroll apo posedim armët në fjalë, fakti se janë gjendur fotografi në telefonin e tij, nuk nënkupton vetvetiu se i njëjti edhe i ka poseduar ato armë. Prandaj sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nga provat e ofruara nga ana e organit të akuzës, nuk është arritur të provohet se me veprimet e tij, i pandehuri ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale për të cilën i njëjti akuzohet.

Gjykata përfundimisht vlerëson se provat në të cilat është mbështetur prokuroria me rastin e ngritjes së aktakuzës nuk janë të mjaftueshme për ta mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën është ngarkuar si në aktakuzë, i njëjti e ka mohuar të ketë kryer veprën penale, ndërsa me rastin e bastisjes së vendit të ngjarjes-shtëpisë së të akuzuarit, nuk është gjetur asnjë lloj arme.

Në përputhje me nenin 453 paragrafi 1 të KPPK-së, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.333/2023, datë 21.03.2024

Gjyqtari

Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.